

STATUTI

I SHOQATES

“DHOMA TREGTISE SHQIPERI KINE”

KREU I

NENI 1

Emri dhe vula.

1.1 Emri i shoqates eshte “ **Dhoma Tregtise Shqiperi Kine” .**

1.2 Dhoma ka vulen dhe emblemen e saj identifikuese.

NENI 2

Selia

2.1 Dhoma e ka seline ne Tirane, Autostrada Tirane-Durres km 7, prane QTU-se Qendra Henry.

Tel : +355 68 20 30534 - Tel +355 69 21 99148

2.2 Dhoma mund te krijoje dege brenda dhe jashte Shqiperise.

NENI 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e Dhomes eshte e pa kufizuar.

NENI 4

Objektivat


Dhoma eshte nje shoqate jo –fitimprurese qellimet e seciles jane :

1. Te zhvilloje mardheniet tregtare te Shqiperise me R.P. te Kines.
2. Te vezhgoje legjislacionin dhe politikat shqiptare qe ndikojne ne biznes me R.P te Kines.
3. Ne bashkpunim me ambasadeten e R.P. Kines ne Tirane te nxise mardheniet kulturore artistike si dhe ato turistike midis dy vendeve tona.

NENI 5

Veprimtaria e Dhomes

1. Dhoma ndihmon biznesin shqiptar dhe individet ne aktivitetin e tyre te tregtise me ate te Kines.
2. Dhoma sherben si pike reference per informacione biznesi ne te gjitha fushat.
3. Dhoma krijon mardhenie te ndersjellta me homologet e saj si dhe organizatat tregtare ne R.P. te Kines.
4. Dhoma analizon ndryshimet dhe zhvillimet e ligjeve, politikave dhe rregullave te qeverise Shqipetare qe kane lidhje me biznesin.



1

5. Dhoma organizon seminare dhe aktivitete te tjera te cilat ndihmojne ne permbushjen e objektivave te saj.
6. Dhoma zbaton programe bashkepunimi biznes – qeveri.
7. Dhoma i pergjigjet kerkesave per informacion, referanca biznesi, takimeve midis biznesmenve kineze dhe shqipetare, si edhe rekombandon firma dhe kompani tregtare kineze per te bashkepunuar me analoget e tyre ne Shqiperi.
8. Perkrah dhe inkurajon negocjata dhe marveshje tregtare bilaterale dhe multiraterale.
9. Dhoma jep asistence ne perpilimin e dokumentacionit te nevojsphem per paisjen me licence te tregtareve kineze per te ushruar aktivitetin e tyre ne territorin e Shqiperise sipas ligjeve ne fuqi.
10. Rekomandon ambasadat respektive te dy vendeve tona per te lehtesuar procedurat aplikimit per viza udhetimi te tregtareve kinez dhe shqipetar.

11. Dhoma ndermerr cdo veprim tjeter te ligjshem qe e ndihmon ate per te permbushur objektivat e saj.

12. Dhoma ka te drejte te marre pjese ne tenderime dhe prokurimin e granteve, te kontraktimeve dhe shi&bljerjen nga ana e organeve shteterore, te sherbimeve publike te mallrave dhe pasurive publike, si dhe te transferimit te sherbimeve publike dhe pasurimeve perkatese nga sektori publik tek organizatat jo fitim prurese.

NENI 6

Politikat dhe Programet e Dhomës

1. Dhoma nuk do te vendoset dhe nuk do te marre rolin e nje “ndermjetesi te vecante” ne emer te nje industrie ose hapsire gjeografike te caktuar nepermjet pozicionimit per nje ceshtje qe ka interes vetem per ate industri ose hapsire.
2. Dhoma do te evitoje nderhyrjen ne ceshtje te ngushta te natyres nder-industriale, sic jane ceshtjet qe kane te bejne vetem me nje grup ose segment te vecante brenda nje industrie.
3. Ne cdo rast dhe kurdohere, politikat dhe programet e Dhomës do jene ne themelim te objektivave te saj dhe ne perputhje me strukturen e treguar ne nenin 4.

NENI 7

Burime Financiare

1. Dhoma ka burimet financiare te meposhtme per zhvillimin e veprimitarive te saj :
 - a) kuotat dhe kontributet e antaresise ;
 - b) dhurimet nga personat e lejuar fizike dhe juridik , vendas ose te huaj ;
 - c) te ardhurat nga sherbimet e Dhomës;
 - d) burime te tjera te ligjshme.
2. Dhoma nuk do te pranoje asnje ndihme financiare nga ndonje qeveri ose agjensi e saj, ose nga cdo burim tjeter qe do te synonte kufizimin e lirise se veprimit te Dhomës.

NENI 8

Antaret e Dhomës

*Bujedoci Buzaf Bef. 2
Yll*

1. Antare te Dhomës mund të jene persona fizike ose juridike, vendas ose te huaj.
2. Bordi i Drejtoreve, here pas here, do të percaktoje kuotat që do të kerkohen për antaresine.
3. Bordi i Drejtoreve mund të percaktoje kategori të ndryshme anetaresie, me kuota dhe kontributet të ndryshme, me kusht që të kete një baze të arsyeshme për kategoritë e ndryshme dhe që anetaret brenda një kategorie të trajtohen njesoj.

NENI 9

Anetaresia

1. Një antar mund të behet cdo person që pranon statutin dhe paguan rregullisht detyrimet.
2. Një antar mund të perjashtohet nga Dhoma për sjellje diskretituse ose të demshme për objektivat dhe qellimet e Dhomës ose kur ai nuk i permabhet statusit ose rregullave të Dhomës.
3. Perjashtimi i një antari vendoset nga Asambleja, ne perputhje me nenin 10, me rekomandim të Bordit të Drejtoreve, rekomandim ne te cilin paraqiten arsyet ku bazohet propozimi.
4. Një anetar mund të jape doreheqjen nga Dhoma në cdo kohe nepermjet dorezimit të doreheqjes se tij me shkrim ne seline e Dhomës.

KAPITULLI II

ORGANET E DHOMËS

NENI 10

Asambleja

1. Asambleja perbehet nga të gjithë antaret e Dhomës me qendrim të rregullt.
2. Asambleja:
 - a) miraton statutin e Dhomës, aktet e saj, si dhe amendamentet e tyre;
 - b) miraton programet e Dhomës;
 - c) zgjedh bordin e Drejtoreve;
 - d) mbikqyr aktivitetet e Dhomës, te ardhurat e saj, dokumentat e saj financiare, si dhe pasurite edhe pronat e saj;
 - e) vendos në lidhje me pranimin ose perjashtmin e anetareve dhe per cdo çeshtje tjeter që nuk eshte lene ne kompetence te ndonje organi tjeter te Dhomës;
 - f) vendos mbi shperndarjen ose mbylljen e Dhomës.

NENI 11

Mbledhjet e Asamblee dhe Vendimmarrja

1. Asambleja thirret nga bordi i drejtues, presidenti i Dhomës ose me kërkesë 1/5 se anetareve të Asamblee.
2. Asambleja mblidhet rregullisht te pakten dy here ne vit, duke perfshire një mbledhje vjetore.

Buzëdorek Beqaj

Baf. Ylli

3. Ne cdo mbledhje te Asamblese, kuorumi perbehet prej te pakten nje te dyten e anetareve te Dhomes, personalist prezant ose te perfaqesuar me prokure . Me perjashtim te rastit te parashikuar ne paragrafin 4 , vendimet merren me shumicen e votave te anetareve, te cilet jane prezant ose perfaqesohen me prokure , ne mbledhje ku eshte arritur kuorumi.
4. Cdo ndryshim ose shtese ne statutin e Dhomes, shperndarja ose mbyllja e Dhomes , si dhe perjashtimi i ndonje anetari kerkon nje shumice votuse prej dy te tretave te anetareve prezant ose te perfaqesuar me prokure me kusht qe te ekzistoj kuorumi.
5. Te gjithe anetaret e Dhomes te cilet kane te drejte vote, kane te drejten e nje vote ne cdo mbledhje te Asamblese .
6. Asambleja mund te marre nje vendim edhe pa u mbledhur , ne qofte se te gjithe anetaret japin pelqimin me shkrim per marrjen e nje vendimi te tille.

NENI 12

Bordi i Dhomes

1. Dhoma drejtohet dhe administratohet nga nje Bord Drejtues (Bordi). Bordi perbehet nga 5 deri ne 11 anetare. Nje anetar Bordi qe mban aktualisht pozicionin e anetarit te Bordit, nuk mund te mbaj nje pozicion Bordi apo ekzekutivi ne nje Dhome tjeter tregtie apo ne ndonje organizate te ngashme. Nje anetar Bordi e ka te ndaluar te nxjerre apo te perdore informacione konfidenciale qe ka marre ndersa ka sherbyer si anetar Bordi prane Dhomes Shqiptare. Anetaret e Bordit duhet te deklarojn para te gjithe Bordit menjehere cdo konflikt interesit aktual ose te mundshem, qe kane ose mund te kene. Anetari i Bordit duhet ti bindet propozimit te Bordit apo te jape doreheqjen.
2. Anetaret e Bordit , i cili perbehet nga presidenti , zevendes presidenti , financieri , sekretari dhe nga antare te tjere sic vendoset nga Asambleja , zgjidhen nga Asambleja per nje periudhe prej 4 vjetesh. Kjo behet per te evituar zgjedhjen e menjehereshme te te gjithe perberjes se Bordit. Anetaret e Bordit jane perqejges perpara Asamblese per permbushjen e detyrate te tyre. Ata mund te rizgjidhen , qofte si anetare te Bordit , ashtu dhe si punonjes te tij.
3. Nje person mund te mbaje me shume se nje post , me perjashtim qe presidenti dhe financieri nuk duhet te jete i njejti person.
4. Nje anetar i Bordit mund te jape doreheqjen nga Bordi ne cdo kohe duke dorezuar doreheqjen e tij / te saj me shkrim ne seline e Dhomes.
5. Nje anetar i Bordit mund te shkarkohet nga Bordi ose nga Asambleja kur ai ose ajo , pa ndonje arsy , nuk mer pjesa ne 4 mbledhje brenda nje periudhe kohe prej 1 viti. Anetare te Bordit mund te shkarkohen perpara mbarimit te afatit te tyre vetem nga Asambleja dhe vetem per nje aresye te bazuar.
6. Cdo anetar i Bordit , ashtu si dhe nje grup prej 10 anetaresh te Asamblese, mund te kerkonte fillimin nga Asambleja te procedurave te shkarkimit te presidentit , te ndonje anetari te Bordit ose te cdo punonjesi tjeter.
7. Bordi duhet te plotesoje vendin vakant te krijuar nga doreheqja ose shkarkimi ne daten me te afert te mundeshme , me shumice votash , me nje anetar zevendesues i cili do te krye funksionin deri ne mbledhjen e ardhshme te Asamblese. Afati kohor fillestar i nje anetari te Bordit i zgjedhur per te zevendesuar nje anetar te meparshem zgjat vetem deri ne perfundimin e mandatit te anetarit te Bordit , te cilin ai / ajo zevendesoi ai / ajo mund te rizgjidhen.

*Buzedorec...
Buzedorec...
Buzedorec...
Buzedorec...*

- Si Bordi ashtu edhe Asambleja mund te rrisin numrin e Drejtoreve brenda kufijve te percaktuara ne paragrafin 1. Cdo rritje e tille duhet te behet me numer tek. Megjithate, fakti qe Bordi Drejtues mund, qe nga koha ne kohe, te perbehet nga nje numer cift anetaresh per shkak vdekje, doreheqje, shkarkimi ose shkaqe te tjera nuk do te bejne te pavlefshme vendimet e marra prej tij ne peruthje me kete Statut.
- Me perjashtim te rasteve kur vendet vakante jane krijuar nga Asambleja , Bordi i ploteson vendet vakante te krijuara nepermjet nje rritje ne perputhje me paragrafin 8 me shumice votash te anetareve, te cilet vazhdojne punen deri ne mbledhjen e ardhshme te Asamblese dhe kane te drejte te rizgjidhen. Asambleja mund ta zvogeloje numrin e drejtueseve brnda kufijeve te percaktuara ne paragrafin 1, gjithmone me nje numer tek.

NENI 13

Bordi Fillestar Drejtoreve

Bordi i pare perbehet nga 8 persona :

- | | |
|--------------------|--------------|
| 1. Bujar Bedalli | President |
| 2. Sherif Braksi | Zv President |
| 3. Bujar Taullah | Sekretar |
| 4. Spartak Nano | Anetar |
| 5. Ylli Xhakollari | Anetar |
| 6. Song Ying Chun | Anetare |
| 7. Liri Lika | Anetare |
| 8. Alma Allkja | Financiere |

NENI 14

Funkzionet e Bordit

- Bordi aprovon buxhetet e Dhomes dhe amendamentet e tij ;
- Bordi aprovon statutin fillestar ;
- Bordi aprovon strukturen dhe personelin e Dhomes dhe percakton pagat dhe shperblimet e te gjith te punesuarve te Dhomes;
- Bordi emerion dhe shkarkon Presidentin me shumice absolute te anetareve te tij;
- Bordi i propozon Asamblese perjashtimin e cdo anetari te Dhomes dhe pranimin e anetareve te rinj si dhe amendamentet e statutit.

NENI 15

Rregullat e Funkcionimit te Bordit

- Bordi mblidhet rregullisht te pakten nje here ne cdo tre muaj. Mbledhjet e Bordit thirren nga presidenti , ose nga $\frac{1}{2}$ e anetareve te Bordit ne detyre .

The image shows several handwritten signatures in black ink, likely belonging to the members of the Board of Directors mentioned in the document. The signatures are fluid and vary in style, with some being more legible than others. They are positioned above a horizontal line, which is the signature line for the document.

2. Sekretari i dergon rendin e propozuar te cdo mbledhje tek anetaret e Bordit te pakten tre dite perpara mbledhjes ose , neqoftese eshte nje mbledhje e jashtezakonshme , sa me shpejt qe te jete e mundur perpara mbledhjes. Asnje ceshtje e paparashikuar ne rendin e dites te nje mbledhjeje te jashtezakonshme e te derguar nga sekretari nuk mund te shqyrtohet , me perjashtim te rasteve kur te gjithe anetaret e Bordit janin pelqimin me shkrim.
3. Mbledhja e Bordit eshte e vlefshme ne qofte se jane prezent me shume se gjysma e anetareve te tij.
4. Bordi i merr vendimet me shumice votash te anetareve te tij , te cilet jane personalisht prezent , me perjashtim te vendimit per te shkarkuar ose te marre masa disiplinore ndaj Presidentit i cili do te merret vetem me shumice absolute te anetareve te Bordit.
5. Procesverbalet mbahen ne cdo mbledhje te Bordit dhe ruhen ne seline e Dhomes.
6. Cdo vendim i Bordit i cili vjen ne kundershtim me depzitat e ketij statusi , eshte i pavlefshem.

NENI 16

Presidenti

1. Presidenti i Bordit eshte ne te njejten kohe dhe presidenti i Dhomes.
2. Presidenti eshte perfaqesuesi zyrtar i Dhomes.
3. Presidenti kryeson mbledhjet e Asamblese dhe te Bordit.
4. Presidenti bashkpunon me sekretarin dhe zevendes presidentin e bordit ne cdo ceshtje dhe nenshkruan te gjithe korespondencen e pergjithshme.
5. Presidenti miraton marrjen ne pune dhe largimin nga puna te punonjesve te Dhomes me propozim te zevendes presidentit. Ai raporton menjehere me shkrim cdo veprim te tille anetareve te tjere te Bordit.
6. Ne rast mungese ose kur lindin probleme te tjera ne ushtrimin e detyres nga ana e presidentit , zevendes presidenti e zevendeson presidentin ne te gjitha detyrat e tij.

NENI 17

Zevendes Presidenti i Bordit

1. Zevendes presidenti i bordit menaxhon dhe perqigjet para Bordit dhe Presidentit per aktivitetet e Dhomes duke perfshire dhe veprimet e perditishme.
2. Zevendes presidenti i bordit drejton te gjitha veprimet sherbimet dhe stafin e Dhomes ; ai koordinon dhe drejton biznesin e saj.
3. Zevendes presidenti i bordit i propozon Presidentit marrjen ne pune dhe largimin nga puna te punesuarve .
4. Zevendes presidenti i bordit perqatit projekt-buxhetin.
5. Zevendes presidenti i bordit ka te drejte te bledhe fonde , te cilat pasi mblidhen , behen pjesa e buxhetit te Dhomes.
6. Zevendes presidenti i bordit i raporton Bordit jo me pak se nje here ne muaj ; ai eshte i detyruar ti raportoj bordit ne cdo kohe qe Bordi e kerkon nje gje te tille.

NENI 18

Bujedaae Shqip. GJL

WMP

YLL